

VENDIM
Nr.414, datë 7.6.2006

**PËR KRYERJEN NGA POSTA SHQIPTARE SHA, TË SHËRBIMEVE, POSTARE DHE
FINANCIARE, TË MINISTRIVE, INSTITUCIONEVE BUXHETORE,
NDËRMARRJEVE DHE SHOQËRIVE ME KAPITAL SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 pika 1, 8, pika 5, e 11, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministritë, institucionet buxhetore, ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital shtetëror, shërbimet bazë postare të postës së letrave t’i realizojnë nëpërmjet Postës Shqiptare, sh.a.
2. Shpërndarja e faturave të konsumatorëve, të lëshuara nga KESH sh.a, Albtelecom, sh.a., dhe shoqëritë tregtare të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., të bëhet nga Posta Shqiptare sh.a., me tarifa të reduktuara, deri në 50 për qind, të postës së letrave.
3. Arkëtimet për pagesat në shuma jo më të mëdha se 100 000 (njëqind mijë) lekë, për transaksion, të bëhen edhe pranë sporteleve të Postës Shqiptare sh.a., për:
 - a) licencat dhe lejet e lëshuara nga ministritë dhe institucionet e tyre të varësisë;
 - b) gjobat e vendosura nga ministritë dhe institucionet e tyre të varësisë, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.
4. Arkëtimet për pagesat e faturave të lëshuara për abonentët familjarë, nga KESH, sh.a., Albtelecom sh.a., dhe shoqëritë tregtare të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., të kryhen edhe në sportelet e Postës Shqiptare, sha.
5. Posta Shqiptare, sh.a., të lidhë kontrata me KESH sh.a., Albtelecom, sh.a., dhe shoqëritë tregtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, sh.a., për kryerjen e shërbimeve të arkëtim-pagesave.
6. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha